

Ndikimi ekonomik i **DokuFest 2025**



Ndikimi ekonomik i
DokuFest 2025

Nëntor 2025

— **Përmbajtja**

Përmbledhje ekzekutive	3
1. Hyrje	4
2. Metodologjia	5
3. Informata statistikore për pjesëmarrjen në DokuFest 2025	6
4. Ndikimi ekonomik i DokuFest 2025	10
5. Përfundim	17

Përmbledhje ekzekutive

Për të pestën herë, Instituti GAP ka vlerësuar ndikimin ekonomik të festivalit DokuFest 2025, një prej ngjarjeve kulturore më të rëndësishme në Kosovë dhe më gjerë në rajon. Vlerësimi është bërë duke u bazuar në të dhënat e mbledhura nga anketat me vizitorët e festivalit, me qëllim që të kuptohet më saktë niveli i shpenzimeve të tyre gjatë qëndrimit dhe mënyra se si këto shpenzime ndikojnë në ekonominë lokale.

Gjatë vitit 2025, festivali DokuFest tërhoqi gjithsej 15,507 vizitorë. Rezultatet e raportit tregojnë se ndikimi ekonomik i këtij edicioni në ekonominë e Kosovës, vetëm nga shpenzimet për konsum, arriti shumën mbi 5.2 milionë euro, një rritje prej 30% krahasuar me edicionin e vitit 2023. Ndikimi ekonomik i festivalit në Bruto Produktin Vendor, duke përfshirë efektin e importeve, kap vlerën rreth 3.7 milionë euro. Ky kontribut ekonomik u shpërnda në disa sektorë, përfshirë gastronominë, akomodimin dhe transportin. Përveç rëndësisë së madhe kulturore që ka DokuFest për vendin, investimi në organizimin e edicionit të vitit 2025 rezultoi tejet efektiv edhe financiarisht, pasi për çdo 1 euro të investuar u gjeneruan 9 euro për ekonominë vendore.

Gjetjet kryesore të këtij raporti janë:

- Në DokuFest 2025 morën pjesë gjithsej 15,507 vizitorë. Nga këta, 53% (8,166) ishin vizitorë të rinj që po merrnin pjesë në festival për herë të parë, ndërsa 47% (7,341) kishin marrë pjesë edhe në edicionet e mëparshme të festivalit.
- DokuNights mbetet aktiviteti më i preferuar i vizitorëve, me 64% të të anketuarve që kanë marrë pjesë ose planifikojnë të marrin pjesë në këtë aktivitet, pasuar nga DokuTalks (panelet e diskutimit) me 46% të pjesëmarrjes.
- Rreth 60% e vizitorëve theksojnë atmosferën e veçantë të festivalit si motivin kryesor të pjesëmarrjes së tyre. Ndërkaq, 49% e vizitorëve e rendisin interesimin për filmat dhe krijuesit e pranishëm si arsyen e dytë më të rëndësishme për të marrë pjesë në festival.
- Në bazë të anketës, rreth 33% e vizitorëve të DokuFest ishin vizitorë ndërkombëtarë, me pothuajse gjysmën e tyre që po e vizitonin vendin për herë të parë.
- Shumica e vizitorëve patën një përvojë shumë pozitive. Rreth 63% u shprehën shumë të kënaqur, ndërsa 16% deklaruan se ishin deri diku të kënaqur. Vetëm 1% e vizitorëve shprehën pakënaqësi. Festivali rezultoi i suksesshëm dhe i qëndrueshëm, gjë që dëshmohet nga fakti se rreth 91% e pjesëmarrësve planifikojnë të kthehen sërish vitin e ardhshëm.
- Sipas të dhënave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), qarkullimi i bizneseve në Prizren gjatë muajit gusht 2025 kur është mbajtur festivali, ka shënuar një rritje prej 3%. Konkretisht, të hyrat e përgjithshme kanë arritur vlerën prej 113.8 milionë euro, krahasuar me 110.3 milionë euro të regjistruara në muajin korrik të vitit 2025.
- DokuFest solli përfitime të rëndësishme ekonomike për Kosovën. Për çdo 1 euro të investuar në festival, ekonomia ka përfituar 9 euro shpenzime. Nëse analizohen vetëm fondet publike të investuara, ndikimi është edhe më i madh: për çdo 1 euro publike të shpenzuar, festivali ka gjeneruar 35 euro për ekonominë e vendit.
- Shpenzimet mesatare ditore të vizitorëve që janë banorë të Prizrenit gjatë DokuFest 2025 ishin 52.7 euro, ndërsa të vizitorëve nga vendet jashtë Prizrenit ishin 102.2 euro.
- Vizitorët nga vendet jashtë Prizrenit shpenzuan kryesisht për akomodim (27.1% e shpenzimeve), si dhe ushqim dhe pije (23% e shpenzimeve), duke treguar kështu se këto dy kategori përbëjnë gjysmën e shpenzimeve të tyre gjatë qëndrimit në Prizren.

1. Hyrje

DokuFest është festival ndërkombëtar i filmit dokumentar dhe të shkurtër me renome botërore që organizohet çdo vit në qytetin e Prizrenit. Nga viti 2002 kur është organizuar për herë të parë, ky festival është shndërruar në një ngjarje kulturore me rëndësi ndërkombëtare, duke e pozicionuar Prizrenin si një destinacion të rëndësishëm turistik dhe kulturor si në Kosovë ashtu edhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Edicioni i 24-të i festivalit i mbajtur në vitin 2025 prezantoi një program të pasur me 213 filma, 9 shfaqje, 8 diskutime tematike, 4 masterklasa profesionale dhe 6 workshope/punëtori.¹ Të gjitha këto aktivitete u shpërndanë në 9 kinema dhe hapësira kreative të përshtatura nëpër qytet, duke tërhequr vizitorë nga vende të ndryshme të botës.² Gjatë pjesëmarrjes në festival, vizitorët kanë mundësi të eksplorojnë bukuritë natyrore të Kosovës si dhe vendet e ndryshme turistike. Krahas atyre që ndjekin aktivitetet e festivalit si pjesëmarrës direkt në të, qyteti i Prizrenit tërheq edhe shumë turistë të tjerë që dëshirojnë të përjetojnë atmosferën e veçantë që krijohet në qytet gjatë kësaj periudhe. Në këtë mënyrë, festivali sjell përparësi të mëdha në Kosovë si në aspektin kulturor ashtu edhe në atë ekonomik. Për rrjedhojë, është e rëndësishme të bëhet një vlerësim i ndikimit ekonomik të DokuFest në Kosovë.

DokuFest gjatë vitit 2025 tërhoqi 15,507 vizitorë. Vlera ekonomike e gjeneruar nga shpenzimet e vizitorëve arriti në mbi 5.2 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 30% krahasuar me vlerësimet e edicionit të mëparshëm të vitit 2023 të bërë nga Instituti GAP. Analiza e thelluar e kontributit në Bruto Produktin Vendor (BPV), e cila saktësohet duke përfshirë efektin e importeve, tregon se ndikimi real i festivalit në ekonominë e Kosovës ishte rreth 3.7 milionë euro.

Bazuar në llogaritjet e kthimit në investime, del se për çdo 1 euro të investuar janë gjeneruar 9 euro për ekonominë e Kosovës. Ndërsa, nëse analizohet kthimi në investime vetëm nga fondet publike, del se për çdo 1 euro të investuar, janë gjeneruar 35 euro.

Sipas vlerësimit të Institutit GAP, DokuFest 2025 ka gjeneruar një vlerë shpenzimesh prej mbi 5.2 milionë euro në ekonominë kosovare. Këto shpenzime janë shpërndarë pothuajse në mënyrë të barabartë mes sektorëve të ndryshëm ekonomikë, duke përfshirë industrinë e akomodimit, gastronomisë, transportit dhe sektorë të tjerë. Në këtë mënyrë, DokuFest nuk ka shërbyer vetëm si një ngjarje kulturore, por si një shtytës ekonomik nga i cili ka përfituar jo vetëm qyteti i Prizrenit, por gjithë Kosova.

¹ DokuFest. [DokuFest 2025 Announces the Winners of its 24th Edition](#). Qasur më 12 shtator 2025.

² Ibid.

2. Metodologjia

Në këtë raport, Instituti GAP ka bërë vlerësimin e ndikimit ekonomik të DokuFest 2025 përmes mbledhjes së të dhënave parësore nga anketimi i vizitorëve të festivalit. Anketimi është realizuar nga kompania e specializuar për përgatitjen e anketave 'IDRA Consulting Agency', përmes së cilës janë mbledhur të dhëna lidhur me shpenzimet e pjesëmarrësve gjatë festivalit. Për të siguruar saktësinë dhe përfaqësimin e të dhënave, është përzgjedhur një mostër prej 752 vizitorësh. Në përzgjedhjen e mostrës, është zgjedhur çdo i/e pesti vizitor/e. Ndërsa marzha e gabimit bazuar në rezultatet e anketës ishte 3.8%.


Anketa e përdorur ndër të tjera vlerëson shumën dhe mënyrën e shpenzimeve të vizitorëve gjatë DokuFest 2025. Qëllimi i anketës është të analizojë shpenzimet e përgjithshme të vizitorëve sipas sektorëve të ndryshëm ekonomikë, për të kuptuar se ku shkojnë këto shpenzime dhe për të vlerësuar ndikimin e festivalit në këta sektorë. Gjithashtu, për të llogaritur shpenzimet totale, ishte e nevojshme të dihen dy të dhëna kryesore: numri i përgjithshëm i vizitorëve dhe shpërndarja e tyre sipas vendit të origjinës. Kjo e dyta ishte veçanërisht e rëndësishme, pasi vizitorët nga vende të ndryshme pritej të shpenzonin shuma të ndryshme gjatë festivalit.

Krahas anketës, vlerësimi ekonomik mbështetet edhe në të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) për qarkullimin e deklaruar të bizneseve në Prizren gjatë muajit gusht 2025, kur edhe është mbajtur festivali. Duke qenë se të dhënat e ATK-së mund të mos pasqyrojnë ndikimin e plotë ekonomik për shkak të informalitetit në sektorin privat, të dhënat nga anketa ofrojnë një vlerësim më gjithëpërfshirës. Si rrjedhojë, për llogaritjen e ndikimit ekonomik, janë analizuar fillimisht të dhënat nga anketa dhe më pas janë krahasuar me ato të ATK-së për të verifikuar përputhshmërinë mes tyre.

3. Informata statistikore për pjesëmarrjen në DokuFest 2025


Sipas organizatorëve, festivali DokuFest gjatë vitit 2025 pati gjithsej 15,507 vizitorë. Prej tyre, 8,166 vizitorë (53%) morën pjesë për herë të parë në festival, ndërsa 7,341 vizitorë (47%) kishin marrë pjesë edhe në edicionet e mëparshme të festivalit.

Figura 1. Numri i pjesëmarrësve në DokuFest 2025, pjesëmarrësit e rinj dhe ata të viteve të mëparshme




Rezultatet e anketës tregojnë se 74% e vizitorëve ishin të informuar që festivali përveç dokumentarëve dhe filmave të shkurtër, ofron edhe aktivitete të tjera si punëtori, master klasa, ekspozita dhe panele diskutimi. Ndërkohë, 26% e të anketuarve nuk ishin në dijeni për këto aktivitete shtesë të cilat i ofron festivali.

Figura 2. Njohuria e vizitorëve për aktivitetet e ofruara të DokuFest-it




Nisur nga kjo, DokuNights mbetet aktiviteti më i preferuar i vizitorëve, me 64% të të anketuarve që kanë marrë pjesë ose planifikojnë të marrin pjesë në këtë aktivitet. Në vendin e dytë renditen DokuTalks (panelet e diskutimit) me 46% të pjesëmarrjes, pasuar nga forumi i filmave të shkurtër (36%), master klasat (28%), punëtoritë (24%) dhe aktivitetet e tjera (2%).

Figura 3. Aktivitetet në të cilat vizitorët kanë marrë pjesë apo planifikojnë të marrin pjesë (pyetje me opsione të shumëfishta)




Lidhur me arsyet e pjesëmarrjes në festival, shumica e vizitorëve të anketuar (60%) përmendën dëshirën për të përjetuar atmosferën e festivalit si motivin kryesor. Në anën tjetër, 49% e pjesëmarrësve morën pjesë për shkak të interesimit për filmat dhe krijuesit e pranishëm, 41% morën pjesë për të zgjeruar njohuritë e tyre në fushën e kulturës dhe artit, ndërsa 32% morën pjesë me rekomandime nga familjarët dhe shoqëria.

Figura 4. Arsyet e pjesëmarrjes në festival (pyetje me opsione të shumëfishta)




DokuFest 2025 tërhoqi 5,650 vizitorë ndërkombëtarë. Nga këta, 46.7% (2,639 persona) vizituan Kosovën për herë të parë, 38.7% (2,186 persona) e kishin vizituar Kosovën disa herë më parë, kurse 14.6% (825 persona) e kishin vizituar vendin vetëm një herë në të kaluarën.

Figura 5. Vizitorët ndërkombëtarë të DokuFestit dhe ardhja e tyre në Kosovë




Lidhur me planet e vizitorëve ndërkombëtarë për vizita në vendet e Kosovës, rezultatet tregojnë se 50% e tyre preferojnë të qëndrojnë vetëm në Prizren, 23% kanë interesim të vizitojnë edhe vendet tjera, 16% veçse kanë vizituar edhe vendet tjera, dhe 11% e vizitorëve ende nuk kanë vendosur nëse do të vizitojnë vendet e tjera gjatë festivalit. Për sa i përket aktiviteteve të planifikuara gjatë qëndrimit në Kosovë, shumica e vizitorëve ndërkombëtarë kanë shprehur interes për aktivitete kulturore (77.4%), ecje në natyrë (66%), si dhe pjesëmarrje në aktivitete aventureske si via ferrata, zipline, parqe aventurash, shëtitje me biçikletë, kajak dhe paragliding (37.7%). Kurse, sa i përket buxhetit të planifikuar për shpenzime në këto destinacione, 71% e vizitorëve ndërkombëtarë planifikojnë të shpenzojnë deri në 100 euro, ndërsa 29% e tyre planifikojnë të shpenzojnë mbi 100 euro.

Figura 6. Planifikimi i vizitorëve ndërkombëtarë për të vizituar qytetet e tjera në Kosovë




Gjatë vitit 2025, DokuFest vazhdoi të ofrojë një gamë të pasur aktiviteteve që plotësuan pritshmëritë e shumicës së vizitorëve. Rezultatet e kënaqshmërisë tregojnë se nga të gjithë pjesëmarrësit: 63% (9,733 vizitorë) ishin shumë të kënaqur me përvojën e tyre në festival, 18% (2,846 vizitorë) kishin qëndrim neutral, 16% (2,475 vizitorë) ishin deri diku të kënaqur, 2% (330 vizitorë) ishin deri diku të pakënaqur dhe 1% (123 vizitorë) u shprehën të pakënaqur me përvojën e DokuFest 2025.

Figura 7. Përvoja e vizitorëve në DokuFest 2025



Një gjetje tjetër e rëndësishme nga anketa ishte se rreth 91% e të anketuarve shprehën interes për të marrë pjesë në festival edhe në edicionin e vitit të ardhshëm. Specifikisht, 67.3% e tyre deklaruan se pjesëmarrja e tyre vitin e ardhshëm është shumë e mundshme, dhe 23.3% u shprehën se pjesëmarrja e tyre në edicionin e ardhshëm të festivalit është e mundshme.

Figura 8. Gjasat për pjesëmarrje në DokuFest vitin e ardhshëm



4. Ndikimi ekonomik i DokuFest 2025

Bazuar në të dhënat e anketës, Instituti GAP analizon ndikimin direkt dhe indirekt të festivalit në ekonomi. Ndikimi direkt llogaritet nga shpenzimet operative të festivalit që ndikojnë drejtpërdrejt në ekonomi, duke përfshirë shpenzimet për burimet njerëzore, pajisjet, marketingun dhe shpenzimet e tjera. Ndërsa, ndikimi indirekt është vlerësuar përmes tri metodologjive të ndryshme. Së pari, janë analizuar të dhënat e ATK-së mbi qarkullimin e bizneseve në Prizren gjatë muajit gusht 2025, për të identifikuar rritjen e aktivitetit ekonomik gjatë kohës së festivalit. Së dyti, janë përpunuar rezultatet e anketimit të vizitorëve për të llogaritur shpenzimet e tyre në kategori si ushqim dhe pije, akomodim, transport, suvenire, e të tjera. Për më tepër, vizitorët janë kategorizuar sipas origjinës së tyre në vizitorë të Prizrenit, vizitorë nga qytetet e tjera të Kosovës, vizitorë nga diaspora, si dhe vizitorë të huaj. Në këtë mënyrë, duke u bazuar në numrin total të vizitorëve, janë llogaritur shpenzimet për konsum, që shfaqin ndikimin indirekt të festivalit në ekonomi. Në anën tjetër, duke marrë parasysh që shumë produkte të konsumuara në Kosovë janë të importuara, është bërë një llogaritje e shpenzimeve për konsum duke eliminuar efektin e importeve (vlerësuar në 30% të konsumit).³ Kjo metodë përcakton ndikimin e DokuFest 2025 në Bruto Produktin Vendor (BPV), duke matur kështu kontributin real të shpenzimeve të vizitorëve në ekonominë vendore, pa i përfshirë importet.

4.1. Ndikimi direkt

Për realizimin e DokuFest 2025, organizatorët e festivalit kanë shpenzuar gjithsej 496,871 euro. Shpenzimet janë ndarë në këto kategori: 150 mijë euro për burime njerëzore, akomodim dhe transport, rreth 8 mijë euro për marketing, 172 mijë euro për pajisje, logjistikë, të drejtat e shfaqjes së filmave, mirëmbajtje, përkthim dhe titrim, si dhe 168 mijë euro për çmimet e fituesve, performanca muzikore dhe shpenzime të tjera operative.

Krahasuar me vitin 2023, pothuajse të gjitha kategoritë e shpenzimeve kanë pësuar rënie, me përjashtim të shpenzimeve për ndarjen e çmimeve për fituesit, performacave muzikore dhe shpenzimeve tjera operative, të cilat kanë shënuar rritje prej 59%.

Tabela 1. Shpenzimet direkte për organizimin e DokuFest për vitet 2023 dhe 2025, në euro

Shpenzimet	2023	2025	Ndryshimi në %
Burime njerëzore, akomodim, transport	176,561 €	150,248 €	-15%
Marketing, media sociale, software – web	12,083 €	7,930 €	-34%
Pajisje, logjistikë, të drejtat për shfaqje të filmit, përkthim, titrim, printim	222,481 €	172,342 €	-23%
Ndarja e çmimeve për fituesit, performanca muzikore dhe shpenzime të tjera operative	105,733 €	168,351 €	59%
Gjithsej shpenzimet	516,858 €	496,871 €	-4%

³ Në këtë vlerësim është zbritur efekti i importeve për shkak të nivelit të lartë të varësisë nga mallrat dhe shërbimet e huaja që ka vendi, duke e shumëzuar kështu vlerën totale të shpenzimeve me 70%.

4.2. Ndikimi indirekt

Ndikimi ekonomik i DokuFest 2025 është vlerësuar duke mbledhur të gjitha shpenzimet e vizitorëve gjatë pjesëmarrjes së tyre në festival. Të dhënat e shpenzimeve janë siguruar nga rezultatet e anketës dhe janë shumëzuar me numrin e vizitorëve gjatë periudhës së festivalit. Si rezultat, janë bërë dy llogaritje të ndikimit ekonomik: ndikimi në shpenzimet për konsum dhe ndikimi në BPV.

Në tabelën e mëposhtme, paraqiten të dhënat e llogaritjeve të ndikimit ekonomik të festivalit që Instituti GAP ka realizuar ndër vite. Sipas këtyre të dhënave, në vitin 2025, festivali pati ndikim të konsiderueshëm në konsum me mbi 5.2 milionë euro dhe në BPV-në e vendit me rreth 3.7 milionë euro. Ndërkaq, ndikimin më të ulët në konsum dhe në BPV festivali ka pasur gjatë vitit 2021, gjë që ishte e parashikueshme për shkak të gjendjes së vështirë që mbizotëronte në vend si pasojë e pandemisë COVID-19.

Tabela 2. Ndikimi ekonomik i DokuFest ndër vite

	2011	2015	2021	2023	2025
Ndikimi në shpenzime për konsum në euro	2,585,283 €	4,733,937 €	2,666,307 €	4,027,764 €	5,250,641 €
Ndikimi në Bruto Produktin Vendor (BPV) në euro	2,068,226 €	2,461,647 €	1,866,415 €	2,819,434 €	3,675,449 €

4.2.1 Supozimet në vlerësimin e ndikimit ekonomik

Supozimet e përdorura nga Instituti GAP për llogaritjen e ndikimit ekonomik të DokuFest 2025 janë:

1. Numri i përgjithshëm i vizitorëve në DokuFest 2025 ishte 15,507 vizitorë. Nga ky numër, 27.5% e vizitorëve ishin nga Prizreni; 22.1% ishin shtetas të Kosovës që jetojnë jashtë Prizrenit, 5.2% shqiptarë të diasporës që kanë ardhur vetëm për DokuFest, 4.7% shqiptarë të diasporës që gjatë periudhës së DokuFest ishin duke vizituar të afërmit në Prizren, 4.1% shtetas ndërkombëtarë që jetojnë në Kosovë, si dhe 36.4% vizitorë ndërkombëtarë që kanë ardhur në Prizren enkas për DokuFest.
2. Bazuar në të dhënat e anketës, shpenzimet mesatare të vizitorëve të DokuFest 2025 variojnë sipas origjinës. Banorët e Prizrenit shpenzuan më pak se grupet e tjera, me mesatarisht 186.3 euro gjatë gjithë festivalit. Shtetasit e Kosovës që jetojnë jashtë Prizrenit shpenzuan mesatarisht 370.2 euro. Shqiptarët e diasporës që erdhën posaçërisht për festival shpenzuan mesatarisht 395 euro, ndërsa ata që po vizitonin të afërmit në Prizren gjatë kësaj periudhe shpenzuan më pak, rreth 350.8 euro. Shtetasit ndërkombëtarë me banim në Kosovë kontribuan mesatarisht me 407.6 euro. Ndërsa, grupi me shpenzimet më të larta ishin vizitorët ndërkombëtarë që udhëtuan enkas për DokuFest, me një mesatare prej 461.5 euro për person.
3. Në këtë llogaritje janë paraqitur dy projeksione, njëri që bën llogaritjen e ndikimit ekonomik që përfshin të gjitha shpenzimet (tabela 3) dhe tjetri i cili përfshin shpenzimet duke larguar efektin e importit (tabela 5).
4. Duke qenë se Kosova ka varësi të konsiderueshme nga mallrat dhe shërbimet e huaja, një pjesë e shpenzimeve të konsumit rrjedh jashtë vendit. Prandaj, për llogaritjen e këtij efekti në model, shpenzimet e konsumit janë shumëzuar me koeficientin 70%, i cili reflekton prirjen për import si rezultat i kombinimit

të faktorëve ekonomikë, gjeopolitikë dhe shoqërorë të vendit. Diferenca në mes të ndikimit sipas shpenzimeve të konsumit dhe ndikimit në BPV shpjegohet me nivelin e lartë të importeve në ekonominë vendore.


5. Ngjashëm sikur në vlerësimin e kaluar, edhe këtë vit në vlerësim është larguar efekti i multiplikatorit si pasojë e rritjes së ndjeshme të importeve.

4.2.2 Ndikimi sipas qarkullimit të bizneseve

DokuFest me numrin e konsiderueshëm të vizitorëve, ka sjellur rritje të ndjeshme në sektorët e turizmit, tregtisë dhe shërbimeve, duke pasur ndikim në ekonominë lokale në Prizren. Bazuar në të dhënat e ATK-së, gjatë muajit gusht 2025 kur u mbajt festivali, qarkullimi i bizneseve në Prizren arriti vlerën prej 113.8 milionë eurosh. Kjo përfaqëson një rritje prej 3% (rreth 3.5 milionë euro më shumë) krahasuar me muajin korrik 2025. Ndërsa, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të mëparshëm tregon një rënie prej 10%, duke qenë se në gusht 2024 qarkullimi i bizneseve ishte rreth 126.9 milionë euro.

Ndonëse raporti nuk bën ndonjë lidhje kauzale mes festivalit dhe rritjes së qarkullimit të bizneseve, meqë nuk është bërë një modelim lidhur me këtë, shpenzimet e dokumentuara nga vizitorët e këtij festivali dëshmojnë për një ndikim pozitiv të tij tek bizneset në Prizren, meqë muaji gusht kur mbahet festivali paraqet edhe muajin me qarkullimin më të lartë të bizneseve.

Figura 9. Deklarimi i qarkullimit të bizneseve të Prizrenit në ATK gjatë muajve qershor-shtator, në euro



4.2.3 Ndikimi në shpenzimet për konsum

Shpenzimet e konsumit përbëjnë faktorin kryesor që ndikon në rritjen e BPV-së së një vendi. Kur konsumatorët shpenzojnë më shumë për produkte dhe shërbime, krijohet një kërkesë më e lartë në treg, e cila rrjedhimisht stimulon aktivitetin ekonomik të vendit.

Për të vlerësuar ndikimin ekonomik të DokuFest 2025, u analizuan shpenzimet totale të vizitorëve gjatë periudhës së festivalit, duke u bazuar në rezultatet e anketës. Shpenzimet u kategorizuan sipas llojit (ushqim dhe pije, akomodim, transport, etj.) dhe sipas vendbanimit të vizitorëve, duke nxjerrë një mesatare ditore për secilën kategori të vizitorëve. Bazuar në shpërndarjen proporcionale të

vizitorëve sipas vendbanimit në mostrën e anketuar, këto mesatare u shumëzuan me numrin përkatës të vizitorëve dhe ditëve të pjesëmarrjes në festival.


Këto rezultate të detajuara janë shfaqur në tabelën 3 më poshtë. Sipas llogaritjes, ndikimi i përgjithshëm ekonomik i festivalit në aspektin e shpenzimeve për konsum arriti vlerën prej mbi 5.2 milionë euro. Vizitorët ndërkombëtarë që erdhën posaçërisht për DokuFest 2025 gjeneruan kontributin më të madh ekonomik me rreth 2.5 milionë euro, të ndjekur nga qytetarët e Kosovës që jetojnë jashtë Prizrenit me mbi 1.2 milionë euro. Kontributin më të ulët ekonomik e kishin shqiptarët e diasporës që gjatë periudhës së festivalit vizitojnë të afërmit në Prizren me 241 mijë euro, kryesisht për shkak të pjesëmarrjes së tyre relativisht më të ulët në festival.

Tabela 3. Ndikimi në shpenzimet për konsum për vitin 2025, për 14,800 vizitorë⁴

Vendbanimi i vizitorëve	Shpërndarja e vizitorëve sipas vendbanimit	Shpenzimet mesatare ditore	Frekuentimi mesatar ditë/netë	Gjithsej shpenzimet
Prizreni	4,074 (27.5%)	52.69 €	3.5	759,072 €
Qytetet tjera të Kosovës	3,267 (22.1%)	117.28 €	3.2	1,209,467 €
Diaspora, shqiptarët e diasporës që kanë ardhur vetëm për DokuFest 2025	768 (5.2%)	112.43 €	3.5	303,156 €
Diaspora, shqiptarët e diasporës që gjatë periudhës së festivalit vizitojnë të afërmit në Prizren	689 (4.7%)	129.24 €	2.7	241,633 €
Vendet e huaja, shtetasit ndërkombëtar që jetojnë në Kosovë	610 (4.1%)	108.92 €	3.7	248,670 €
Vendet e huaja, shtetasit ndërkombëtar që kanë ardhur enkas për DokuFest 2025	5,392 (36.4%)	125.70 €	3.7	2,488,644 €
Gjithsej ndikimi në shpenzimet për konsum				5,250,641 €


Bazuar në rezultatet e anketës, banorët e Prizrenit shpenzojnë mesatarisht 17.9 euro në ditë gjatë ditëve të zakonshme. Megjithatë, gjatë DokuFest, shpenzimet e tyre mesatare ditore janë rritur në 52.7 euro, që paraqet një rritje prej më shumë se dyfish. Për sa u përket vizitorëve nga jashtë, qofshin ata nga qytetet e tjera të Kosovës, diaspora apo vizitorë të huaj, shpenzimet mesatare ditore gjatë DokuFest arritën në 102.2 euro.

⁴ Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në festival është 15,507 vizitorë, ku 707 prej tyre i kanë pasur të mbuluara shpenzimet nga organizatorët e festivalit.

Figura 10. Shpenzimet ditore të banorëve të Prizrenit

Duke pasur parasysh që vizitorët që vijnë nga jashtë Prizrenit shpenzojnë dyfish më shumë se qytetarët vendas, dhe që akomodimi përbën pjesën më të madhe të shpenzimeve të tyre, në figurën e mëposhtme është pasqyruar vetëm shpërndarja e shpenzimeve për vizitorët jo-vendas.

Sipas figurës 11, shpenzimet e vizitorëve të jashtëm janë të ndara kryesisht në këto kategori: akomodim (27.1%), ushqim dhe pije (23%), bileta për DokuNights (12.1%), bileta për filma (10%), shpenzime të tjera (9%), transport (7.7%), dhurata dhe suvenire (7.4%) si dhe produkte të festivalit (3.7%).

Figura 11. Shpërndarja e shpenzimeve të deklaruar të personave që jetojnë jashtë Prizrenit

Si vlerë financiare, shpenzimet për ushqim dhe pije përbëjnë kategorinë me shpenzimet më të larta me mesatarisht 23.9€ për person në ditë. Kjo kategori pasohet nga akomodimi (23.7€), shpenzimet për bileta për DokuNights (15.7€), biletat për filma (11.5€), shpenzimet e tjera të përgjithshme (10.3€), transporti (7.5€), suveniret dhe dhuratat (6.4€), si dhe produktet e DokuFestit (3.2€). Në total, gjatë gjithë festivalit, vizitorët që nuk jetojnë në Prizren shpenzojnë më së shumti për ushqim dhe pije (83.3 € për person), si dhe akomodim (82.5€ për person).

Tabela 4. Zbërthimi i shpenzimeve të peshuara të vizitorëve që jetojnë jashtë Prizrenit, në euro

Kategoria	Akomodim	Ushqim dhe pije	Transport	Dhurata/Suvenire	Bileta për DokuFest 2025 për person (Filma)	Bileta për DokuFest 2025 për person (DokuNights)	Produkte të DokuFest-it	Shpenzime të tjera	Gjithsej shpenzimet e peshuara
Mesatarja e shpenzimeve ditore për person (në euro)	23.7 €	23.9 €	7.5 €	6.4 €	11.5 €	15.7 €	3.2 €	10.3 €	102.2 €
Gjithsej shpenzimet për një person gjatë festivalit	82.5 €	83.3 €	26 €	22.4 €	39.9 €	54.5 €	11.3 €	36 €	355.8 €

4.2.3 Ndikimi në Bruto Produktin Vendor (BPV)

BPV paraqet vlerën totale të mallrave dhe shërbimeve të prodhuara brenda territorit të një vendi në një periudhë të caktuar kohore. Ky tregues ekonomik është thelbësor për vlerësimin e madhësisë dhe performancës së ekonomisë së vendit.

Në kontekstin e këtij raporti, ndikimi i DokuFest 2025 në BPV është analizuar duke përjashtuar efektin e importeve, për të ofruar kështu një matje sa më të saktë të ndikimit ekonomik të festivalit. Për rrjedhojë, duke pasur parasysh që rreth 30%⁵ e produkteve të konsumuara në Kosovë janë të importuara, shpenzimet për konsum janë rillogaritur në mënyrë që të përfshihet vetëm pjesa e shpenzimeve që mbetet në ekonominë vendore.

Sipas rezultateve të këtij raporti, ndikimi ekonomik i DokuFest 2025 në BPV të Kosovës është vlerësuar në rreth 3.7 milionë euro, siç paraqitet në tabelën 5 më poshtë. Ky vlerësim është arritur duke llogaritur shpenzimet mesatare ditore të vizitorëve sipas kategorive të ndryshme, si dhe kohëzgjatjen e qëndrimit të tyre. Vlen të theksohet se në këtë llogaritje për të pasqyruar më saktë ndikimin real ekonomik, vlera totale e shpenzimeve është shumëzuar me koeficientin 70%, duke zbritur kështu efektin e importeve, për shkak të varësisë së konsiderueshme që Kosova ka në importin e mallrave dhe shërbimeve të huaja.

5 Në këtë vlerësim është zbritur efekti i importeve për shkak të nivelit të lartë të varësisë nga mallrat dhe shërbimet e huaja që ka vendi, duke e shumëzuar kështu vlerën totale të shpenzimeve me 70%.

Tabela 5. Ndikimi i DokuFest 2025 në Bruto Produktin Vendor (BPV) për vitin 2025, për 14,800 vizitorë⁶

Vendbanimi i vizitorëve	Shpërndarja e vizitorëve sipas vendbanimit	Shpenzimet mesatare ditore	Frekuentimi mesatar ditë/netë	Gjithsej shpenzimet
Prizreni	4,074 (27.5%)	52.69 €	3.5	531,351 €
Qytetet tjera të Kosovës	3,267 (22.1%)	117.28 €	3.2	846,627 €
Diaspora, shqiptarët e diasporës që kanë ardhur vetëm për DokuFest 2025	768 (5.2%)	112.43 €	3.5	212,209 €
Diaspora, shqiptarët e diasporës që gjatë periudhës së festivalit vizitojnë të afërmit në Prizren	689 (4.7%)	129.24 €	2.7	169,143 €
Vendet e huaja, shtetasit ndërkombëtar që jetojnë në Kosovë	610 (4.1%)	108.92 €	3.7	174,069 €
Vendet e huaja, shtetasit ndërkombëtar që kanë ardhur enkas për DokuFest 2025	5,392 (36.4%)	125.70 €	3.7	1,742,051 €
Gjithsej shpenzime në Prizren / Kosovë (ndikimi direkt në BPV në afat të mesëm)				3,675,449 €

4.2.4 Kthimi në investime

Sa i përket financimit të DokuFest 2025, festivali arriti të gjenerojë një buxhet total prej 586,119 euro. Burimi kryesor i financimit përbëhet nga fondet private me 201,750 euro (35% të totalit). Financimi nga fondet publike ishte në shumën prej 148,000 euro (25%), ndërsa të hyrat nga shitjet dhe shërbimet gjeneruan 126,965 euro (22%). Projektet kontribuan me 64,000 euro (11%) ndërsa ambasadat me 45,404 euro (8%).

Tabela 6. Burimet e financimit të festivalit, 2025

Financimi	2025
Gjithsej financimi nga fondet	148,000 €
*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	95,000 €
*Komuna e Prizrenit	51,000 €
*Qendra Kinematografike e Kosovës	2,000 €
*Të tjera	/
Ambasadat në Kosovë	45,404 €
Financimi nga fondet private	201,750 €
Të hyrat nga projektet DokuFest 2025	64,000 €
Të hyrat nga shitja dhe shërbimet	126,965 €
Të hyrat e bartura	/
Gjithsej financimet	586,119 €

⁶ Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në festival është 15,507 vizitorë, ku 707 prej tyre i kanë pasur të mbuluara shpenzimet nga organizatorët e festivalit.

Duke u bazuar në të dhënat financiare të festivalit dhe analizën e shpenzimeve për konsum, është bërë edhe analiza e kthimit në investime. Për të realizuar këtë, është llogaritur një multiplikator⁷ ku ndikimi total në shpenzimet për konsum prej mbi 5.2 milionë euro është krahasuar me financimin total të festivalit prej 586 mijë euro. Nisur nga kjo, vlera e multiplikatorit del të jetë 9. Rrjedhimisht, për çdo 1 euro të investuar, janë gjeneruar 9 euro për ekonominë e Kosovës.

Ndërsa, nëse e analizojmë kthimin në investime vetëm nga paratë publike, del se kthimi është pothuajse katërfish më i lartë. Meqenëse një e katërta e financimit të festivalit është bërë nga fondet publike, sipas llogaritjeve del se kthimi në investime është 35. Më konkretisht, për çdo 1 euro të investuar nga fondet publike, janë gjeneruar 35 euro për ekonominë e Kosovës. Pra, kthimi në investime është mjaft i lartë, si nga gjithsej fondet e investuara ashtu edhe nga fondet publike të investuara.

5. Përfundim

DokuFest ka bërë Prizrenin një qendër turistike rajonale, duke tërhequr vizitorë nga mbarë bota. Festivali gjatë edicionit të vitit 2025, ka sjellë mijëra turistë në qytetin e Prizrenit, të cilët përveç programit të festivalit, shijojnë edhe atmosferën e qytetit, duke shpenzuar para në akomodim, gastronomi dhe aktivitete të ndryshme turistike. Kjo ka kontribuar pozitivisht në zhvillimin e sektorit të turizmit dhe ekonomisë lokale.

Sipas analizës së Institutit GAP, DokuFest edhe gjatë vitit 2025 ishte një nga festivalet me ndikimin më të madh ekonomik në Kosovë. Me 15,507 vizitorë vendas dhe ndërkombëtarë, festivali realizoi shpenzime prej rreth 497 mijë euro për paga, akomodim, transport, marketing dhe aktivitete të tjera organizative. Ndikimi i përgjithshëm ekonomik vlerësohet në mbi 5.2 milionë euro, ndërsa kontributi në BPV të Kosovës ishte rreth 3.7 milionë euro.


Nisur nga të dhënat e financimit dhe llogaritjet e ndikimit të festivalit në shpenzimet për konsum, del se për çdo 1 euro të investuar, u gjeneruan 9 euro për ekonominë kosovare. Ndërsa, kur analizohen vetëm investimet nga fondet publike, kthimi është edhe më i lartë, me 35 euro të gjeneruara për çdo 1 euro të investuar.

Si përfundim, përgjatë viteve, DokuFesti ka arritur të tërheqë një audiencë të madhe dhe është shëndrruar në një shtyllë të rëndësishme të jetës kulturore kosovare. Festivali funksionon jo vetëm si një platformë kulturore, por edhe si një katalizator ekonomik që sjell përfitime të konsiderueshme jo vetëm për Prizrenin, por për gjithë Kosovën, duke demonstruar kështu ndikimin e tij të madh në ekonominë vendore.


⁷ Multiplikatori në këtë rast është llogaritur duke pjesëtuar vlerën e ndikimit të festivalit në shpenzimet për konsum me vlerën e financimit të festivalit.

Shtojcat – Të dhëna statistikore të tjera nga anketa


Shtojca 1. Pjesëmarrja gjinore në DokuFest 2025




Shtojca 2. Numri i vizitorëve në DokuFest 2025 sipas shteteve




Shtojca 3. Pjesëmarrësit e DokuFest 2025 që jetojnë në Kosovë sipas rajonit të banimit



Shtojca 4. Renditja e garave më të preferuara nga vizitorët e DokuFest 2025



Shtojca 5. Metodat e përzgjedhjes së filmave nga vizitorët (pyetje me opsione të shumëfishta)





Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr. 4, 10000 Prishtinë

Tel.: +383 38 609 339

info@institutigap.org

